

**AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELP” SH.P.K.**

NENI 1

Shtetasi z.**Ilmi Islam PAJA**, i dt.lindjes 03 shkurt 1969 ,lindur ne Durres dhe banues ne Maminas,Durres , madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar , mbajtes i pasaportes me nr. Z1222895 , leshuar me dt.13 shtator 2004, themelon shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar “**ELI**” sh.p.k., ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregetare” si dhe te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 “Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregetar”.

NENI 2

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe me dispozitat e statutit qe i bashkangjiten ketij akti themeltar.

NENI 3

Emertimi i shoqerise “**ELI**” sh.p.k. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**ELI**” sh.p.k. fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 4

OBJEKTI i veprimtarise te kesaj shoqerie do te jete:

- Ndertimin dhe projektimin e objekteve te ndryshme,ekonomike,civile, industriale,turistike, bujqesore dhe ushtarake si banesa, komplekse turistike, zyra, hoteleri,pishina etj.Rikostruksione.

-Puse-cpime gjeologo inxhinierike- cpime per uje.

Punime bojatisje-hidroizolim-termoizolim-akustike-kundrazjarrit.

Mirembajtja,zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane.

-Prodhim dhe shitje material ndertimi.

Tregtim me shumice dhe pakice , import- eksport I mallrave te ndryshme industriale ,bujqesore, ushqimor, blektoral, lende te para per industrine. te gjitha llojeve te produkteve ushqimore, tregetim makinerish dhe pajisje tekstili ,pajisje hidrosanitare, elektrike,I pjeseve te tyre te kembimit , turizem, hoteleri , investime dhe kryerjen e sherbimeve ne keto sektore pune.

-Transaksione te cdo lloji per vete dhe per te tretet, konsulenca tregtare, Agjensi Turistike, Agjensi Imobiliare si dhe perfaqesime dhe cdo veprimtari tjeter te lejueshme nga legjislacioni shqiptar .

NENI 5


Selia e shoqerise eshte ne Maminas ,Durres .Aktiviteti i shoqerise mund te shtrihet ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise.Per kete shoqeria ka te drejte te cele filiale, dege, agjensi apo perfaqesi ne te gjitha qytetet e Republikes se Shqiperise , ne perputhje me legjislacionin perkates.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**ELI**” sh.p.k. perbehet nga shuma ne te holla ne vleren 100.000 leke (njeqind mije) prone eskluzive e ortakut te vetem themelues.

NENI 7

Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen ate te parashikuar ne nenin 6.Me vendim te ortakut te vetem, kapitali themeltar mund te rritet, duke percaktuar edhe numrin e

Ilmi Paşa


dividendeve qe zoteron ortaku I vetem ose ortaket, ne rast se do te kete te tille ne te ardhmen.

NENI 8

Ortaku I vetem I shoqerise eshte z. **Ilmi Islam PAJA**.

NENI 9

Administrator i shoqerise eshte z. **Ilmi Islam PAJA**.

NENI 10

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 10 vjet
Shoqeria mund te prishet para afatit duke zbatuar te gjitha procedurat ligjore te percaktuara per kete qellim dhe pasi te kete shlyer te gjitha detyrimet ndaj te treteve.

NENI 11

Fitimet e shoqerise i perkasin vetem themeluesit te saj.

NENI 12

Shoqeria angazhohet ne te gjitha veprimtarine e saj te veproje ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe te akteve te themelimit te saj. Ajo angazhohet qe ne veprimtarine e saj te udhëhiqet nga korrektesia ne marrëdhënie me te tretet dhe shtetin.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
"ELI"**

Ilmi Islam PAJA

Ilmi Paja
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE



Nr. 2451 Rep.

Nr. 763 Kol.

VERTETIM

Ne Vore sot, me dt. 02 korrik 2007, para meje, noteres, Manushaqe A. Selmani, me seli ne Vore, m'u paraqit personalisht: shtetasi z. **Ilmi Islam PAJA**, i dt. lindjes 03 shkurt 1969, lindur ne Durres dhe banues ne Maminas, Durres, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. Z1222895, leshuar me dt. 13 shtator 2004, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. Z0531502, leshuar me dt. 01 prill 2003, i cili deklaroi se sa me siper eshte akt-themelimi I shoqerise "ELI" Sh.P.K. I redaktuar me vullnetin e lire e te plote te tij me cilesine e administratorit se shoqerise, te cilin ai e nenshkroi rregullisht para meje. Ne keto kushte une noteria bazuar ne nenin 55 te ligjit "Per Noterine" e vertetoj rregullisht kete gje.

NOTERE
Manushaqe Selmani



STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELI” SH.P.K.

1.KRIJIMI,FORMA, EMERTIMI ,OBJEKTI,SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ELI” SH.P.K. me Seli ne Maminas ,Durres , eshte krijuar sipas aktit te themelimit te cilit i bashkangjitet ky statut i perpiluar dhe i nenshkruar nga Shtetesi z.**Ilmi Islam PAJA** , i dt.lindjes 03 shkurt 1969 ,lindur ne Durres dhe banues ne Maminas,Durres , madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar , mbajtes i pasaportes me nr. Z1222895 , leshuar me dt.13 shtator 2004 .

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe normat e ketij statuti.Ajo do t'i nenshtrohet licensimi per aktivitetin qe do te ushtroje nga organet shteterore kopetente.Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne zyren e regjistrimit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 3

Emertimi i shoqerise eshte “ELI” SH.P.K.

NENI 4

OBJEKTI i veprimtarise te kesaj shoqerie do te jete:

- Ndertimin dhe projektimin e objekteve te ndryshme,ekonomike,civile, industriale,turistike, bujqesore dhe ushtarake si banesa, komplekse turistike, zyra, hoteleri,pishina etj.Rikostruksione.

-Puse-cpime gjeologo inxhinierike- cpime per uje.

Punime bojatisje-hidroizolim-termoizolim-akustike-kundrazjarrit.

Mirembajtja,zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane.


-Prodhim dhe shitje material ndertimi.

Tregtim me shumice dhe pakice , import- eksport I mallrave te ndryshme industriale ,bujqesore, ushqimor, blektoral, lende te para per industrine. te gjitha llojeve te produkteve ushqimore, tregetim makinerish dhe pajisje tekstili ,pajisje hidrosanitare, elektrike,I pjeseve te tyre te kembimit , turizem, hoteleri , investime dhe kryerjen e sherbimeve ne keto sektore pune.

-Transaksione te cdo lloji per vete dhe per te tretet, konsulenca tregtare, Agjensi Turistike, Agjensi Imobiliare si dhe perfaqesime dhe cdo veprimtari tjeter te lejueshme nga legjislacioni shqiptar .

NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Maminas,Durres.Aktiviteti i shoqerise mund te shtrihet ne te gjithethe territorin e Republikes se Shqiperise.Per kete shoqeria ka te drejte te cele filiale, dege, agjensi apo perfaqesi ne te gjitha qytetet e Republikes se Shqiperise , ne perputhje me legjislacionin perkates.

Ilmi Paja




NENI 6

Kohezgjatja e shoqerise esht percaktuar per nje periudhe kohore mbi 10 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit te saj. Ajo mund te shperbehet ne c' do kohe kur e vendos ortakut i vetem, per shkaqe qe gjen ai te perligjura, apo ne raste te tjera te parashikuara ne ligj.

II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njeqindemije) I ndare ne 100 kuota,ku cdo kuot ka vleren e 1000 lekeve

NENI 8.

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontributi I ortakut te vetem. Kapitali themeltar I mesiperme mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem. Ai mund te rritet edhe ne natyre.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Pjeset e kapitalit themeltar mund t' u transferohen personave te trete me miratimin e ortakut te vetem. transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt noterial.

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOMPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQERISE.

NENI 10

Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga ortakut i vetem i cili ka kompetence:

- Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise-te vendos per shtimin , pakesimin ose transferimin e kapitalit themeltar.
- Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise
- Te beje ndryshime ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise
- Te vendose per mbylljen e aktivitetit te shoqerise ose shnderimin e saj ne nje shoqeri tjetere

-Gjithashtu ai kerkon dhe mer te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise nga administratori, perfaqesuesi ose te punesuarit e tij si dhe kerkon te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria e bilance, libra llogarie, fatura etj.

Vendimet regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahet ne seline e shoqerise.

NENI 11

Ortakut i vetem ka te drejte te caktojte nje apo me shume administratore jashte shoqerise. Administratori i shoqerise do te jete z **Ilmi Islam PAJA** .

. Administratoret e jashtem veprojne si te tille per gjithe kohen e emerimit, por ata mund te shkarkohen me te pare nga ortakut i vetem kur veprojne ne kundersiztim me permbushjen e detyres apo te interesave te shoqerise.

NENI 12

Administratori i shoqerise kryen veprimtarine e tij ne perputhje me kompetencat qe jane dhene nga ortakut i vetem i shoqerise, Kur ato nuk jane percaktuar, veprimtaria dhe kopetencat e tij do te jene ato te percaktuara nga nenet 15,16,17.128,50 e vijues te ligjit 7638 date 19.11.1992 "per shoqerine tregetare"

NENI 13

Ilmi Paja

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i caktuar nga ortaku i vetem i saj.

IV VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

NENI 14

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

NENI 15

Llogarite vjetore, inventari raporti mbi veprimtarine e vitit financiar te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku i vetem, Bilanci vjetor i veprimtarise se shoqerise nxiret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

NENI 16

Fitimet qe realizohen nga veprimtaria e shoqerise, mbasi zbriten shpenzimet dhe fondi rezerve, perdoret nga ortaku i vetem. Ai ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimeve ne perputhje me qellimin qe kryen. Vlerat pasurore e materiale te shoqerise kane mbrojtjen e legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

V. MARREDHENIET E PUNES

NENI 17

Marredheniet e punes ne shoqeri do te rregullohen sipas legjislacionit shqiptar te punes dhe tij te sigurimeve shoqerore. me punonjesit do te lidhen kontrata kolektive dhe individuale. Shoqeria merr persiper te derdhe rregullisht kontributet per sigurimet shoqerore te punonjesve te saj sipas rregullave te vendosura nga legjislacioni ne fuqi.

NENI 18

Te punesuarit jane te detyruar te zbatojne cdo akt ligjor e nenligjor qe lidhet me punen e tyre, normat e ketij statuti dhe kontratat e punes. Per cdo veprim te kundraligjshem te punesuarit pergjigjen vet para ligjit si dhe para shoqerise per demet qe mund ti shkaktojne asaj. Cdo mosmarveshje qe mund te linde midis te punesuarve dhe shoqerise do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

VI PRISHJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 19

Prishja e shoqerise vec rasteve te parashikuara ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerit tregetare mund te behet ne cdo kohe qe gjykohet nga ortaku i vetem, sic mund te jene rastet e rezultateve me humbje te saj etj. Per kete merret vendimi i vecante prej ortakut te vetem. Me marrjen nga ortaku i vetem te vendimit per prishjen e shoqerise, shoqeria hyn ne procesin e likujdimit. Per kryerjen e ketij procesi ortaku i vetem emeron nje ose me shume likujdator te cilet paraqesin dhe bilancin mbi gjendjen e shoqerise. Emertimi i saj ne kete rast do te pasohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim e siper" Pasi behen likujdimet eventuale shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregetar me vendim te gjykates kopetente. Per te gjitha mosmarveshgjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kopetent per zgjidhjen e tyre eshte gjykata.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

"ELI" SH.P.K.

Ilmi I. PAJA

Ilmi I. Paja

